MIDIS "ARMIKUT TË JASHTËM" DHE "ARMIKUT TË BRENDSHËM": DEMONSTRATAT SHQIPTARE TË VITIT 1981 NË DISKURSIN POLITIK DHE TË SIGURISË SË JUGOSLLAVISË SOCIALISTE

Fatmir ARIFI[*], Dorina DAIU[*]

Abstrakt

Ky punim shqyrton në mënyrë kritike diskursin politik dhe të sigurisë së autoriteteve jugosllave mbi demonstratat shqiptare të vitit 1981 në Kosovë, duke u përqendruar në ndërtimin e narratives së "armikut të jashtëm" dhe në ndërthurjen e saj me kategorinë e "armikut të brendshëm". Në qendër të analizës janë pretendimet për përfshirjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Bullgarisë dhe Bashkimit Sovjetik në nxitjen ose organizimin e demonstratave, si dhe mënyra se si këto pretendime u përdorën për të interpretuar krizën politike në Kosovë. Punimi synon të dallojë akuzat e institucioneve jugosllave nga dëshmitë dokumentare që mund t'i mbështesin ato, duke i vendosur burimet në kontekstin e marrëdhënieve politike, kombëtare dhe ndërkombëtare të kohës. Përmes analizës së dokumenteve politike dhe të sigurisë, deklaratave të përfaqësuesve të udhëheqjes jugosllave, shtypit të kohës dhe vlerësimeve të tjera bashkëkohore, shqyrtohet gjithashtu përdorimi i nocioneve "irredentizëm", "separatizëm" dhe "kundërrevolucion" në diskursin politik e juridik të Jugosllavisë socialiste. Vëmendje e veçantë i kushtohet neneve 114, 116 dhe 136 të Kodit Penal federal të vitit 1977, si dhe dallimit ndërmjet etiketimit politik të veprimtarive shqiptare dhe kualifikimit të tyre juridik. Analiza argumenton se narrativa e ndërhyrjes së jashtme u bë pjesë e një interpretimi më të gjerë të krizës, i cili e vendosi mobilizimin politik shqiptar në kuadrin e sigurisë shtetërore dhe të mbrojtjes së rendit kushtetues jugosllav. Për rrjedhojë, demonstratat e vitit 1981 shqyrtohen në raport jo vetëm me pretendimet për ndikime të jashtme, por edhe me kontradiktat e brendshme politike, statusin kushtetues të Kosovës dhe veprimtarinë e organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar.

Fjalë kyçe: *demonstratat shqiptare të vitit 1981; Kosova; Jugosllavia socialiste; armiku i jashtëm; armiku i brendshëm; irredentizmi; separatizmi; kundërrevolucioni; Shqipëria; diskursi politik dhe juridik*.

1. Hyrje

Demonstratat shqiptare të marsit dhe prillit të vitit 1981 në Kosovë përbëjnë një nga zhvillimet më të rëndësishme politike dhe kombëtare në historinë e Kosovës gjatë periudhës së socializmit jugosllav. Ato shënuan një moment kritik në marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe institucioneve të Federatës Socialiste të Jugosllavisë, duke nxjerrë në pah kundërthëniet që karakterizonin pozitën politike e kushtetuese të Kosovës dhe raportet ndërmjet kërkesave kombëtare shqiptare dhe rendit politik jugosllav. Përmasat e mobilizimit, kërkesat e artikuluar gjatë demonstratave dhe reagimi i institucioneve shtetërore e shndërruan krizën e Kosovës në një çështje me rëndësi të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Një nga çështjet që u shfaq menjëherë pas shpërthimit të demonstratave ishte përcaktimi i faktorëve që kishin ndikuar në organizimin dhe zhvillimin e tyre. Strukturat politike dhe të sigurisë të federatës, të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës i interpretuan ngjarjet përmes kategorisë së "veprimtarisë armiqësore", duke

[*] Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë
[*] Instituti i studimeve për Krimet dhe Pasojat Komunizmit-Tiranë

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp87

shqyrtuar mundësinë e ndikimit ose të ndërhyrjes së faktorëve të jashtëm. Në këtë diskurs, një vend të veçantë zinte Republika Populllore Socialiste e Shqipërisë, por u shfaqën edhe pretendime për përfshirjen e faktorëve të tjerë ndërkombëtarë, përfshirë Bullgarinë dhe Bashkimin Sovjetik.

Megjithatë, interpretimi i demonstratave kryesisht përmes ndikimeve të jashtme ngre një problem të rëndësishëm historiografik: në çfarë mase këto akuza mbështeteshin në prova konkrete dhe në çfarë mase pasqyronin mënyrën se si udhëheqja jugosllave e konceptonte dhe e trajtonte krizën politike në Kosovë? Përgjigjja kërkon shqyrtimin kritik të dokumentacionit të kohës dhe dallimin ndërmjet dyshimeve politike, deklaratave publike, vlerësimeve të strukturave të sigurisë dhe dëshmive që mund të provojnë përfshirje të drejtpërdrejtë në organizimin e demonstratave.

Rëndësia e këtij dallimi lidhet me kontekstin politik të Jugosllavisë në fillim të viteve tetëdhjetë. Vdekja e Josip Broz Titos në vitin 1980, kundërthëniet brenda federatës dhe tensionet e trashëguara në marrëdhëniet ndërmjet kombeve dhe kombësive e bënin çështjen e stabilitetit të brendshëm veçanërisht të ndjeshme. Në këto rrethana, shpjegimi i demonstratave si rezultat i veprimtarisë së forcave të jashtme mundësonte paraqitjen e krizës si kërcënim ndaj sigurisë dhe integritetit territorial të Jugosllavisë, duke e zhvendosur vëmendjen nga shkaqet politike, shoqërore dhe kombëtare të mobilizimit shqiptar, përfshirë veprimtarinë paraprake të organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar[1].

Çështja e Kosovës nuk mund të shkëputet nga statusi i saj kushtetues dhe nga kërkesat për avancimin e pozitës politike të shqiptarëve. Kushtetuta e vitit 1974 i dha Kosovës kompetenca më të zgjeruar dhe një pozitë më pjesërisht të avancuar në strukturën federale, përfshirë përfaqësimin e drejtpërdrejtë në organet federale. Megjithatë, Kosova nuk u bë republikë dhe mbeti nën kompetencat kushtetuese të Republikës Socialiste të Serbisë. Kjo pozitë e veçantë, e karakterizuar nga kompetenca paksa më të gjera në krahasim me pozitën e saj të më hershme, por e kufizuar, krijonte hapësirë për interpretime dhe projekte të ndryshme politike. Demonstratat e vitit 1981 e nxorën këtë çështje në plan të parë, duke e shndërruar statusin e Kosovës në një nga nyjat kryesore të krizës politike jugosllave[2].

Për të kuptuar mënyrën se si autoritetet iu përgjigjën kësaj krize, është e nevojshme të analizohet jo vetëm narrativa e "armikut të jashtëm", por edhe kalimi drejt identifikimit të një "armiku të brendshëm". Kjo kategori u portretizua përmes një terminologjie politike dhe juridike që përfshinte nocionet "nacionalizëm", "irredentizëm", "separatizëm" dhe "kundërrevolucion". Përmes tyre, kërkesat politike të shqiptarëve dhe veprimtaria e organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar u vendosën në kuadrin e një kërcënimi ndaj rendit socialist, organizimit kushtetues dhe integritetit territorial të Jugosllavisë.

Megjithëse këto nocione ndërthureshin në diskursin zyrtar serbo-jugosllav, ato nuk kishin kuptim identik. Për këtë arsye, analiza duhet të dallojë funksionin politik të etiketimit nga përmbajtja konkrete e dispozitave ligjore. Në veçanti, shqyrtimi i neneve 114, 116 dhe 136 të Kodit Penal të RSFJ-së, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 1977, ndihmon për të kuptuar bazën juridike mbi të cilën autoritetet formulonin akuza për cenimin e rendit shoqëror, të integritetit territorial dhe për organizimin e veprimtarive të cilësuara armiqësore. Duhet theksuar se

[1] Agjensia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) Fondi Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësisa Organike Penale, Nr. R. 74-Nr. L 69, Viti 1982, kutis 12, fl, 260-270

[2] Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmbledhje e dispozitave federative, Beograd, 1974, Neni 1 dhe 2, f. 27

"irredentizmi" nuk ishte emërtim i veçantë i një vepre penale në këtë kod, por kategori politike që përdorej për të karakterizuar veprimtari të caktuara kombëtare shqiptare.
Problemi kërkimor i këtij punimi lidhet me marrëdhënien ndërmjet akuzave zyrtare për ndërhyrje të jashtme, shkaqeve të brendshme të demonstratave dhe mënyrës se si institucionet jugosllave e ndërtuan figurën e "armikut të brendshëm". Pyetja qendrore është: si dhe për çfarë arsyesh diskursi politik dhe i sigurisë serbo-jugosllave i interpretoi demonstratat shqiptare të vitit 1981 si rezultat të veprimtarisë së faktorëve të jashtëm dhe, njëkohësisht, si shprehje të veprimtarisë armiqësore brenda Kosovës?
Në funksion të këtij problemi, punimi synon të analizojë: së pari, mënyrën se si u formësuan dhe u zhvilluan pretendimet zyrtare serbo-jugosllave për përfshirjen e Shqipërisë, Bullgarisë dhe Bashkimit Sovjetik në demonstratat shqiptare të vitit 1981; së dyti, dallimet ndërmjet qëndrimeve të përfaqësuesve të ndryshëm të udhëheqjes jugosllave lidhur me shkaqet dhe përmasat e krizës; së treti, raportin ndërmjet bashkëpunimit kulturor, arsimor e shkencor Kosovë-Shqipëri gjatë viteve shtatëdhjetë dhe interpretimeve politike që iu dhanë këtyre marrëdhënieve pas vitit 1981; dhe, së katërti, përdorimin e kategorive "irredentizëm", "separatizëm" dhe "kundërrevolucion" në diskursin politik e juridik të Jugosllavisë socialiste.
Në përputhje me këto objektiva, punimi mbështetet në hipotezën se narrativa zyrtare për "armikun e jashtëm" shërbeu si kornizë politike përmes së cilës autoritetet jugosllave e interpretuan dhe e trajtuan krizën e Kosovës, ndërsa vëmendja ndaj faktorëve të brendshëm politikë, kombëtarë dhe organizativë u ndërthur me këtë kornizë dhe, në disa raste, u la në hije prej saj. Hipoteza e dytë është se përdorimi i nocioneve "irredentizëm", "separatizëm" dhe "kundërrevolucion" kontribuoi në paraqitjen e kërkesave kombëtare shqiptare si çështje të sigurisë shtetërore dhe në de legjitimimin e tyre në diskursin zyrtar.
Punimi shqyrton gjithashtu pretendimet për përfshirjen konkrete të shteteve të huaja në organizimin e demonstratave. Hipoteza nuk mbështetet në përjashtimin apriori të çdo ndikimi të jashtëm, por në parimin se pretendimet për organizim, koordinim ose mbështetje operative duhet të vlerësohen mbi bazën e provave të identifikueshme dhe të verifikueshme. Ekzistenca e rivaliteteve gjeopolitike, e kontakteve ndërkombëtare ose e interesave politike nuk përbën, në vetvete, dëshmi të mjaftueshme për ndërhyrje të drejtpërdrejtë.

2. Hipoteza qendrore

Narrativa zyrtare e autoriteteve politike dhe të sigurisë së Jugosllavisë socialiste për ndërhyrjen e "armikut të jashtëm" në demonstratat shqiptare të vitit 1981 shërbeu si instrument politik dhe ideologjik për interpretimin dhe trajtimin e krizës së Kosovës, duke e zhvendosur vëmendjen nga kundërthëniet e brendshme politike, kushtetuese dhe kombëtare drejt çështjes së sigurisë shtetërore. Kjo narrativë u ndërthur me konstruktimin e figurës së "armikut të brendshëm", përmes së cilës kërkesat politike e kombëtare të shqiptarëve dhe veprimtaria e organizatave të fshehta me orientim çlirimtar u paraqitën si kërcënim ndaj rendit kushtetues dhe integritetit territorial të RSFJ-së.

Hipotezat ndihmëse

Pretendimet e autoriteteve jugosllave për përfshirjen e Shqipërisë, Bullgarisë dhe Bashkimit Sovjetik në organizimin ose nxitjen e demonstratave të vitit 1981 u formësuan në kontekstin e rivaliteteve gjeopolitike dhe të shqetësimeve për stabilitetin e federatës. Megjithatë, këto pretendime nuk mbështeten nga prova dokumentare të drejtpërdrejta për organizimin e

demonstratave nga shtetet e përmendura, ndërsa shkaqet e brendshme politike, kushtetuese dhe kombëtare përbënin një dimension thelbësor të krizës së Kosovës.
Përdorimi i kategorive politike dhe juridike të "nacionalizmit", "irredentizmit", "separatizmit" dhe "kundërrevolucionit" në diskursin zyrtar jugosllav kontribuoi në delegjitimimin e kërkesave politike dhe kombëtare të shqiptarëve, duke mundësuar paraqitjen e tyre si çështje të sigurisë shtetërore dhe legjitimimin e reagimit institucional e ndëshkues ndaj veprimtarisë politike dhe organizative shqiptare.

Metodologjia

Nga pikëpamja metodologjike, studimi mbështetet në qasjen cilësore dhe në analizën kritike, krahasuese dhe kontekstuale të burimeve primare dhe sekondare. Baza dokumentare përfshin materialet arkivore të konsultuara në fondet e Arkivit Qendror Shtetëror të Kroacisë dhe të Arkivit Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, si dhe burime të shtypit të kohës, me theks të veçantë në gazetën Rilindja. Korpusi burimor plotësohet me literaturën historiografike dhe studimet e botuara nga autorë të ndryshëm që trajtojnë demonstratat shqiptare të vitit 1981 dhe kontekstin politik, shoqëror e ndërkombëtar të kësaj periudhe. Dokumentet arkivore, deklaratat e përfaqësuesve të udhëheqjes jugosllave dhe materialet e shtypit shqyrtohen në raport me kontekstin historik dhe institucional të prodhimit të tyre, duke marrë parasysh autorësinë, qëllimin, destinacionin dhe karakterin e tyre politik e ideologjik. Në këtë mënyrë, analiza nuk kufizohet vetëm në evidentimin e të dhënave faktike që përmbajnë burimet, por synon edhe të shqyrtojë mënyrën se si institucionet dhe aktorët politikë të kohës i interpretuan dhe i paraqitën zhvillimet në Kosovë. Vëmendje e veçantë i kushtohet dallimit ndërmjet informacionit dokumentar dhe diskursit ideologjik të përdorur për të cilësuar veprimtarët e organizuar dhe organizatat e fshehta shqiptare me orientim atdhetar e çlirimtar. Përmes ballafaqimit të burimeve arkivore, shtypit bashkëkohor dhe literaturës historiografike, studimi synon të identifikojë përputhjet, mospërputhjet dhe kufizimet e dëshmive, si dhe të vlerësojë në mënyrë kritike pretendimet për ndikimin ose përfshirjen e faktorëve të jashtëm në organizimin dhe zhvillimin e demonstratave të vitit 1981.

* * *

Çështja se kush qëndronte pas organizimit të demonstratave shqiptare të vitit 1981 në Kosovë vazhdon të përbëjë një nga temat më të diskutuara në historiografinë bashkëkohore mbi Kosovën e periudhës së socio-komunizmit jugosllav. Megjithatë, menjëherë pas shpërthimit të demonstratave, strukturat politike dhe të sigurisë së Federatës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Republikës Socialiste të Serbisë dhe Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e interpretuan këtë zhvillim përmes kategorisë së "veprimtarisë armiqësore"[3], duke kërkuar burimin e organizimit dhe nxitjes së tyre jashtë hapësirës jugosllave.
Në këtë mënyrë, u konsolidua një narrativë zyrtare politike dhe juridike sipas së cilës, demonstratat shqiptare të vitit 1981 nuk paraqiteshin si rezultat i kontradiktave të brendshme politike, shoqërore dhe kombëtare në Kosovë, por si pasojë e veprimtarisë së "armiqve të jashtëm"[4], respektivisht e faktorëve të huaj që synonin destabilizimin e Jugosllavisë. Përmes këtij interpretimi, autoritetet jugosllave u përpoqën të përcaktonin burimin e krizës politike

[3]Xhavit Nimani, " *Kundër veprimtarisë armiqësoredo do të ndërmarrim të gjitha masat përkatëse*", Gazeta Rilindja, 03 Prill 1981, f, 1.
[4] Shtypi botëror rreth ngarjeve në Kosovë, Tiranë, 1981

duke ia atribuuar atë ndikimeve të jashtme, ndër të cilat një vend të veçantë zinte Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë[5].

Megjithatë, analiza kritike e dokumentacionit arkivor dhe e burimeve të kohës kërkon që këto pretendime të shqyrtohen në kontekstin politik të Jugosllavisë së fillimit të viteve tetëdhjetë, si dhe në raport me mënyrën se si strukturat shtetërore serbo-jugosllave e konceptonin çështjen e Kosovës. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet ekzistencës së kontakteve politike, kulturore dhe kombëtare ndërmjet shqiptarëve në të dy anët e kufirit dhe pretendimit se shteti shqiptar kishte organizuar drejtpërdrejt demonstratat e vitit 1981.

Në fazat e para pas shpërthimit të demonstratave, qëndrimi i autoriteteve serbo-jugosllave nuk ishte plotësisht i njëtrajtshëm lidhur me natyrën e tyre. Brenda strukturave politike ekzistonte dilema nëse ngjarjet në Kosovë duhej të shpjegoheshin si rezultat i problemeve të brendshme politike dhe shoqërore, apo si pasojë e ndikimeve të faktorëve të jashtëm. Me kalimin e kohës, interpretimi zyrtar u orientua gjithnjë e më shumë drejt tezës së ndërhyrjes së jashtme, duke e vendosur krizën e Kosovës brenda një kornize të sigurisë shtetërore dhe të kërcënimit të sovranitetit territorial të Jugosllavisë.

Ky interpretim kishte një funksion të qartë politik: ai synonte ta zhvendoste vëmendjen nga shkaqet e brendshme që kishin krijuar pakënaqësi të mëdha në Kosovë. Këto pakënaqësi lidheshin me pozitën kushtetuese të krahinës, kërkesat për avancim institucional, pabarazitë politike dhe çështjet që kishin të bënin me pozitën kombëtare të shqiptarëve brenda Federatës Jugosllave. Kërkesa të tilla ishin artikuluar në vazhdimësi nga organizatat e fshehta shqiptare me orientim çlirimtar dhe u shfaqën edhe gjatë demonstratave të vitit 1981[6].

Në vend që këto zhvillime të trajtoheshin si pjesë e një padrejtësie mbi marrëdhëniet ndërmjet çështjes së të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe federatës jugosllave, ato u rikualifikuan si problem i sigurisë kombëtare dhe si kërcënim ndaj integritetit territorial të RSFJ-së.

Një pirje të ngjashme e kishte vërejtur edhe shtypi ndërkombëtar i kohës. Gazeta gjermano perëndimore *Frankfurter Allgemeine* më 9 prill 1981, duke analizuar reagimin e autoriteteve jugosllave ndaj zhvillimeve në Kosovë, theksonte se: "një reagim i zakonshëm i regjimeve që përballen me kriza të brendshme është kërkimi i një "armiku të jashtëm", si mënyrë për të shpjeguar destabilizimin e tyre[7].

Në këtë kuadër, autoritetet federale jugosllave dhe strukturat politike republikane serbe i cilësuan demonstratat e vitit 1981 si "kundërrevolucion" dhe si rezultat të veprimtarisë së qarqeve të jashtme armiqësore. Ky përcaktim nuk përbënte vetëm një kategori juridiko-politike, por shërbeu edhe si instrument ideologjik përmes të cilit kërkesat politike të shqiptarëve të Kosovës u paraqitën si kërcënim ndaj rendit socialist dhe kushtetues të Jugosllavisë[8].

Në dokumentin programatik të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, të titulluar "Platforma politike për aksionin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në

[5]Hrvatski Državni Arhiv (HDA), fond: Savezni sekretarijat za unutrašnje poslove, Analitički osvrt, "Saradnja albanske neprijateljske emigracije sa albanskom obaveštajnom službom i podrška MSR Albanije pokretu za Albansku Socijalističku Republiku u Jugoslaviji", f. 51-59.

[6] Mehmet Hajrizi & Gani Sylaj, *Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës*, (Dokumente dhe materiale), Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2014, f. 21.

[7] Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë, Shtëpia Botuese " 8 Nëntori", Tiranë, 1981

[8] Diskutim nga Mahmut Bakalli në kuadër të Mbledhja e shtatmbëdhjet e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, " Vlerësimi i Shkaqeve, i rrethanave dhe Pasojave të Demonstratave Armiqësore dhe Organizimi e Veprimi i LK dhe i Fuqive të Tjera të Organizuara Socialiste në Kosovë", Komunisti 1981, f, 189.

zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, të vëllazërim-bashkimit dhe të bashkëjetesës në Kosovë", ngjarjet e vitit 1981 interpretoheshin si rezultat i veprimtarisë "armiqësore" të mbështetur nga qendra të huaja. Sipas këtij dokumenti zyrtar, në të cilin shkruan se: "...duke shfrytëzuar ndërlikueshmërinë dhe kontradiktat e situatës së brendshme në Kosovë, forcat kundërrevolucionare kishin synuar 'cenimin dhe shkatërrimin me dhunë të rendit kushtetues' në Kosovë dhe në Jugosllavi"[9].

Në të njëjtin dokument, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë paraqitej si një faktor që, përtej ndikimit të saj kulturor dhe politik, ajo pretendohej se kishte kaluar në mbështetjen e forcave të cilësuara nga autoritetet jugosllave si "irredentiste" dhe "kundërrevolucionare" në Kosovë[10]. Ky interpretim pasqyronte mënyrën se si institucionet jugosllave e trajtonin veprimtarinë e organizatave të fshehta shqiptare me karakter çlirimtar, të cilat kërkonin realizimin e të drejtave kombëtare dhe ndryshimin e statusit politik të Kosovës. Kërkesat dhe veprimtaria e këtyre organizatave interpretoheshin kryesisht përmes kategorive të sigurisë shtetërore dhe të rrezikimit të rendit politik jugosllav, ndërsa u kushtohej më pak vëmendje faktorëve politikë dhe historikë që kishin nxitur pakënaqësinë e akumuluar në mesin e shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht mohimit dhe kufizimit të të drejtave të tyre kombëtare e politike.

Një qasje të ngjashme mbante tërësisht dhe udhëheqja politike e Komitetit Krahinor të Kosovës, strukturë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë-LKJ-së. Në maj të vitit 1981, Azem Vllasi, një nga figurat kryesore të udhëheqjes komuniste të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, deklaronte se "armiku kishte dalë me parulla dhe objektiva të përgatitura nga 'shtabet e fuqive reaksionare", të cilat, sipas tij, "synonin të dëmtonin Kosovën dhe Jugosllavinë socialiste e vetëqeverisëse. Kjo deklaratë dëshmon se, në diskursin politik zyrtar të udhëheqjes krahinore, republikane dhe federative të RSFJ-së, demonstratat dhe veprimtaria politike kombëtare shqiptare interpretoheshin, përveç tjerave, dhe si përpjekje për ta lidhur mobilizimin kombëtar shqiptar në kuadrin ndikimeve të "fuqive reaksionare" të jashtme[11].

Megjithëse në kuadër të diskursit zyrtar serbo-jugosllav mbi demonstratat e vitit 198, brenda vetë këtyre strukturave drejtuese politike ekzistonin dallime në mënyrën e interpretimit të natyrës dhe përmasave të krizës në Kosovë. Këto dallime dëshmojnë se konceptimi i demonstratave si produkt i një veprimtarie të organizuar nga "armiqtë e jashtëm" nuk ishte një interpretim plotësisht i njëtrajtshëm në fillimet e tij, por u konsolidua si pjesë e diskursit zyrtar politik në kuadër të vazhdimit të debateve pasuese.

Një nga interpretimet më të ashpra në këtë drejtim ishte ai i shprehur nga Stane Dolanc, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Më 6 prill 1981, ai deklaronte se "...pas demonstratave shqiptare qëndronin forcat më reaksionare të botës". Sipas tij, "këto forca kishin bashkërenduar veprimtarinë e tyre kundër Jugosllavisë". Ky qëndrim e vendoste krizën e Kosovës brenda një kornize më të gjerë të një kërcënimi të supozuar ndërkombëtar[12].

[9] Komiteti Qëndror i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, "Platforma politike për aksionin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, të vëllazërim-bashkimit dhe të bashkëjetesës në Kosovë., Beograd, 17 nëntor 1981, f.7

[10] Po aty, f, 40

[11] Nga fjala e Azem Vllasit mbajtur në mbledhjen e 17-të të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, mbajtur më 5 maj 1981 në Prishtinë. Botuar në platformën " Vlersimi i Shkaqeve, i Rrethanave dhe i Pasojave të Monsratave Armiqësore dhe Organizimi e Veprimi i LK dhe i Fuqive të Tjera të Organizuar Socialiste në Kosovës", botues " Komunisti", Prishtinë, 1981, f, 175.

[12] Шта се догађало на Косову [Çfarë ndodhi në Kosovë], Политика, Beograd, maj 1981, f. 31.

Pa dyshim brenda udhëheqjes politike serbo-jugosllave ekzistonin edhe qasje më të rezervuara ndaj këtij interpretimi. Jože Smole*, një anëtarë me peshë në kuadër të Federatës Jugosllave, referonte kundër ekzagjerimit të vlerësimeve mbi qëndrimin e faktorëve ndërkombëtarë ndaj Jugosllavisë, duke theksuar rrezikun e kalimit në skajshmëri në interpretimin e situatës. Sipas tij: "nuk duhej krijuar përshtypja as se e gjithë bota ishte mbështetëse e Jugosllavisë së bashkuar, por as se një pjesë e madhe e botës ishte e angazhuar kundër saj"[13]. Qëndrimi i J. Smoles është i rëndësishëm sepse tregon ekzistencën e një debati të brendshëm mbi mënyrën e vlerësimit të dimensionit ndërkombëtar të krizës.

Ndryshe nga interpretimet që i shihnin zhvillimet në Kosovë kryesisht si rezultat të një komploti të jashtëm, në këtë debat duhet vendosur edhe pozicioni i akademikut dhe intelektualit nacionalist serb Dobrica Ćosiq, njërit prej përfaqësuesve më të njohur të nacionalizmit serb në Jugosllavinë socialiste. Ćosiq kishte kritikuar mënyrën se si udhëheqja jugosllave i kishte kategorizuar zhvillimet e vitit 1981 në Kosovë si "kundërrevolucion", duke argumentuar se një interpretim i tillë nuk merrte parasysh dimensionin historik të çështjes shqiptare në Kosovë dhe ekzistencën e aspiratave për bashkim kombëtar si pjesë e një procesi më të gjatë historik.

Në shënimet e tij të datës 26 prill 1981, Ćosiqi argumentonte se "aspiratat shqiptare për bashkim kombëtar nuk mund të shpjegoheshin vetëm si rezultat i ndikimeve të jashtme"[14]. Ky qëndrim është i rëndësishëm për analizën historike, sepse tregon se edhe brenda qarqeve politike dhe intelektuale serbe ekzistonin vlerësime që nuk e reduktonin çështjen shqiptare vetëm në ndikimin e faktorëve ndërkombëtarë.

Megjithatë, kritika e D. Ćosiqit ndaj interpretimit zyrtar jugosllav nuk duhet të kuptohet si mbështetje për kërkesat politike të shqiptarëve të Kosovës apo si një pranim i së drejtës së tyre për realizimin e së drejtës për vetëvendosje. Teza e D. Ćosiqit duhet analizuar në kuadër të zhvillimit të mendimit të tij politik, ku çështja kombëtare serbe në kuadër të RSFJ-së dhe riorganizimit të hapësirës jugosllave zinin një vend qendror. Pikëpamjet e tij mbi Kosovën ishin të lidhura me një doktrinë nacionaliste mbi territorin, kufijtë dhe pozitën e Serbisë në Jugosllavi.

Në këtë kuptim, dhe pse D. Ćosiqi kundërshtonte reduktimin e çështjes shqiptare në një ndikim të thjeshtë të jashtëm, ai nuk e trajtonte atë nga perspektiva e barazisë kombëtare të shqiptarëve në kuadër të Jugosllavisë. Përkundrazi, në shkrimet e tij politike ai vazhdimisht e lidhte çështjen e Kosovës me problemin e pozitës së Serbisë dhe me mundësinë e rishikimit territorial mbi baza etnike e historike. Si personalitet me ndikim në botën akademike dhe politike në Serbi, ai dhe pas vitit 1999, vazhdoi të shprehte ide mbi ndarjen territoriale të Kosovës ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë, duke ruajtur për Serbinë territoret dhe objektet që ai i konsideronte pjesë të trashëgimisë serbe.[15]

Prandaj, analiza e qëndrimeve të ndryshme brenda elitës jugosllave dhe serbe tregon se narrativa e "armikut të jashtëm" nuk ishte thjesht një reagim i pamenduar, por një konstruksion mirë i detajuar me objektiv për dërguar mesazh të gjithë shteteve qofshin ato të sferës perëndimore apo të sferës lindore ndaj për të i dënuar këto demonstrata.

* Jože Smole (1927–1996), gazetar, publicist, diplomat dhe politikan slloven. Për biografinë, shih: Slovenska biografija, https://ëëë.slovenska-biografija.si/oseba/sbi587956/

[13] Dobrica Qosiq: "Kosovo", Novosti, Beograd 2004, f 30-31

[14] Po aty

[15] Po aty, f, 136.

Kështu që, çështja kryesore nuk ishte vetëm nëse ekzistonin apo jo ndikime të jashtme, por mënyra se si këto pretendime u përdorën nga institucionet jugosllave për të ndërtuar figurën e "armikut të jashtëm" dhe për të zhvendosur vëmendjen nga faktorët e brendshëm politikë, shoqërorë dhe kombëtarë shqiptar, që kishin ndikuar në shpërthimin e këtyre demonstratave në Kosovës.

Kush ishin "armiqtë e jashtëm"?

Në diskursin politik dhe të sigurisë të Jugosllavisë socialiste, kërkimi i burimeve të jashtme të rrezikut u bë një element i rëndësishëm i interpretimit të demonstratave shqiptare të vitit 1981. Autoritetet serbo-jugosllave orientuan dyshimet drejt disa shteteve fqinje dhe fuqive të huaja, të cilave u atribuonin synime për destabilizimin e RSFJ-së. Shqipëria, Bullgaria dhe Bashkimi Sovjetik ishin përmendur si shtete që, sipas vlerësimeve të qarqeve të caktuara politike jugosllave, mund të vepronin kundër interesave të Jugosllavisë.

Republika Popullore e Shqipërisë dhe implikimi i saj

Një nga faktorët kryesorë të paraqitur si "armik i jashtëm" në diskursin zyrtar serbo-jugosllav ishte Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Tirana zyrtare u portretizua si qendër e veprimtarisë propagandistike dhe politike që, sipas interpretimeve jugosllave, synonte të ndikonte në zhvillimet kombëtare shqiptare brenda federatës dhe të nxiste veprimtari kundër rendit kushtetues jugosllav.[16]

Këto akuza nuk u kufizuan vetëm në interpretimin e demonstratave si rezultat i një ndikimi të jashtëm. Por u shndërruan në një instrument më të gjerë politik përmes të cilit, autoritetet jugosllave synonin t'i paraqisnin kërkesat për të drejta kombëtare të shqiptarëve nën Jugosllavi, si kërkesa të importuar nga "armiqtë e jashtëm" të Jugosllavisë, në këtë rast dhe nga Republika Popullore e Shqipërisë.

Në këtë rrafsh, kërkesat politike dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës u vendosën brenda kategorive të konceptuale të "irredentizmit", "separatizmit" dhe "kundërrevolucionit", duke e zhvendosur debatin nga përmbajtja e këtyre kërkesave drejt burimit të tyre të pretenduar gjoja të importuar nga jashtë.

Dokumentet politike dhe të sigurisë të prodhuara nga institucionet jugosllave të kohës paraqisnin pretendimin se Shqipëria kishte zhvilluar një veprimtari të organizuar propagandistike dhe subversive kundër Jugosllavisë[17]. Në këtë diskurs, Shqipëria nuk paraqitej thjesht si një shtet me lidhje historike, gjuhësore dhe kulturore me shqiptarët jashtë kufijve të saj, por si një faktor destabilizues që synonte cenimin e rendit kushtetues jugosllav.

Nga këndvështrimi historiografik, këto pretendime duhet të analizohen me kujdes kritik. Në dokumentacionin e shqyrtuar për këtë punim nuk është identifikuar një dokument i drejtpërdrejtë që të dëshmojë se institucionet shtetërore të Shqipërisë e organizuan demonstratat e vitit 1981. Ky konstatim nuk përjashton ekzistencën e interesave politike ose të

[16]Mustafa Sefedini, diskutim: "Vlerësimi i shkaqeve, i rrethanave dhe i pasojave të demonstratave armiqësore dhe organizimi e veprimi i LK dhe i fuqive të tjera të organizuara socialiste në Kosovë", në: Mbledhja e shtatëmbëdhjetë e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, Prishtinë: Komunisti, 1981, f. 113.

[17] HDA, Savezni Sekretarijat Za Unutrasnje Poslove, Analiticki Osvrt, " Saradnja Albanske Neprijateljske Emigracije Sa Olbanskom Obavestajnom Sulizbe i Podrska MSR Albanije " Pokretu za Albansku Socialisticku Republiku u Jugoslaviji"... f, 51-59

kontakteve, por nënkupton se pretendimi për organizim shtetëror duhet të mbështetet në prova më të drejtpërdrejta sesa në deklaratat politike dhe vlerësimet e strukturave të sigurisë jugosllave.

Lidhur me këtë tezë, Mehmet Hajrizi, njëri nga drejtuesit e spikatur të veprimtarisë atdhetare gjatë viteve 1970-1982, ka shkruar se përpjekjet për të dëshmuar se gjoja demonstratat e vitit 1981 ishin organizuar nga Tirana zyrtare nuk kanë qenë të suksesshme[18]. Më tej, ai argumenton se "... kryengritja e vitit 1981 është vepër e vet popullit shqiptarë në Kosovë dhe e Lëvizjes së tij Kombëtare"[19].

Vlerësimi i Mehmet Hajrizit nënvizon rëndësinë e dallimit ndërmjet veprimtarisë së organizatave shqiptare në Kosovë dhe rolit që autoritetet jugosllave ia atribuuan Shqipërisë. Këto të dhëna nuk nënkuptojnë se Shqipëria nuk kishte interesa kombëtare lidhur me realizimin e të drejtave të shqiptarëve që jetonin brenda Jugosllavisë. Nga viti 1969[20] deri në vitin 1980[21], marrëdhëniet ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës u zhvilluan në disa fusha, veçanërisht në arsim, kulturë[22] dhe shkencë. Megjithatë, ekzistenca e këtyre marrëdhënieve institucionale nuk mund të barazohet automatikisht me organizimin ose drejtimin e veprimtarisë politike në Kosovë.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces kishte bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës[23]. Ky bashkëpunim krijoi mundësi për shkëmbime akademike, qarkullimin e literaturës shkencore, angazhimin e kuadrove universitare dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta në fushën e arsimit shkencës dhe kulturës. Për shqiptarët e Kosovës, këto marrëdhënie kishin rëndësi të veçantë. Ato kontribuuan në forcimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të identitetit kombëtar dhe kulturor te shqiptarët që jetonin në trojet e tyre nën Jugosllavi[24].

Pavarësisht kësaj që u tha më sipër, divergjencat në mes të masave të gjëra popullore dhe strukturave federative jugosllave kishin shpërthye në mënyrë demonstrative që në vitin 1968 në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Viti 1968 kishte nxjerrë në mënyrë demonstrative kontradiktat e brendshme të federatës, veçanërisht në raport me të drejtat kombëtare të shqiptarëve në kuadër të RSFJ. Këto zhvillime kontribuuan në intensifikimin e debatit politik për statusin e Kosovës dhe u reflektuan në proceset të më vonshme që çuan drejt ndryshimeve kushtetuese në vitin 1974.

Por vlen të theksohet se në të njëjtën periudhë, Lëvizja Kombëtare Kroate, e njohur si "MasPok*", (Masovni Pokret-1971), dëshmoi se tensionet kombëtare ndërmjet njësive federale të përbërë nga kombe të ndryshme, përbënin një sfidë më të gjerë për sistemin komunist jugosllav. Krahas këtyre zhvillimeve, qarqe nacionaliste serbe, të lidhura politikisht me trashëgiminë e Aleksandar Rankoviqit, vazhdonin të vepronin brenda institucioneve të Republikës së Serbisë, duke synuar forcimin e pozitës së saj dhe të ndikimit mbi njësitë e tjera

[18] Mehmet Hajrizi, "*Dhjetë qëndrime të gabuara ndaj kryengritjes së vitit 1981*" përmbledhje aktesh nga konferenca shkencore me titull: "Demonstratat e vitit 1981 dhe politika shqiptare", Kolegji Biznesi, Prishtinë 2014, f, 26.

[19] Po aty.

[20] AMPJ, viti 1970, Dosja 548, fl, 32

[21] AMPJ, viti 1980, Dosja 1182, Titulli i dosjes, " Kosova", B VII-2/a, fl, 9-21

[22] AMPJ, viti 1977, Dosja 1113, "Udhëzime nga Drejtoria e IV-të, fl. 1-2

[23] AMPJ, viti 1978, Dosja, 1262, tituli I dosjes: "Projekt Protokolli i Bashkpunimit mësimor shkencor midis Universitetit të Tiranës dhe Universiteit të Prishtinës për vitin akademik 1978/79, fl,19-21

[24] Arkivi Qendrore i Shtetit, (AQSH), Fondi 14/APSTR, viti 1979, Dosja 64, fl, 75-77.

*MasPok (Masovni pokret – Lëvizja Masive), e njohur edhe si "Pranvera Kroate", ishte një lëvizje politike dhe reformiste e zhvilluar në Republikën Socialiste të Kroacisë, kryesisht gjatë viteve 1970–1971. Ajo artikuloi kërkesa për autonomi më të madhe politike dhe ekonomike të Kroacisë, si dhe për rishikimin e marrëdhënieve ndërmjet republikave dhe pushtetit federal. Në dhjetor 1971, pas ndërhyrjes së udhëheqjes federale, drejtuesit kryesorë u detyruan të jepnin dorëheqje dhe pasuan masa politike e ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve.

federale. Kështu, fundi i viteve gjashtëdhjetë dhe fillimi i viteve shtatëdhjetë u karakterizuan nga tensione të ndërlidhura kombëtare e politike, të cilat vunë në pah brishtësinë e ekuilibrave mbi të cilët mbështetej federata jugosllave.

Ndonëse në këto rrethana të brishtësisë së marrëdhënieve ndëretnike brenda Federatës Jugosllave, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavinë gjetën një relaksim gradual në mes tyre. Për shtetin shqiptar, fusha e arsimit dhe të kulturës shërbyen si hapësira për rivendosjen dhe zgjerimin e ndikimit të saj mbi shqiptarët e Kosovës dhe viseve të saj. Për udhëheqjen jugosllave, këto marrëdhënie përbënin një mundësi për eksportimin e konceptit të socializmit vetëqeverisës në Shqipëri. Pra që të dy palët, kishin si të thuash objektivat e tyre: njëra ngjalljen e sentimentit kombëtar, tjetra eksportimin e sistemit politik të saj.

Prandaj dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në vitet shtatëdhjetë nuk duhet të interpretohen jashtë realitetit politik të kohës. Ato zhvilloheshin brenda një hapësire të kufizuar diplomatike, ku secila palë kishte objektiva të ndryshme. Jugosllavia synonte që këto marrëdhënie të zhvilloheshin brenda kornizës së sovranitetit të saj mbi Kosovën, ndërsa Shqipëria i shihte ato si mundësi për të forcuar lidhjet me shqiptarët në Jugosllavi, pa e njohur domosdoshmërisht interpretimin jugosllav të sovranitetit mbi Kosovën. Këto dallime politike ndikuan në mënyrën dhe në nivelin e institucionalizimit të bashkëpunimit.

Pikërisht ky dimension i bashkëpunimi arsimor dhe kulturor i marrëdhënieve shqiptaro-shqiptare u bë një nga objektet kryesore të dyshimit të autoriteteve jugosllave kundrejt Shqipërisë, për gjoja organizimin e demonstratave shqiptare të vitit 1981. Bashkëpunimi institucional, shkëmbimi i literaturës, aktivitetet kulturore dhe kontaktet ndërmjet intelektualëve shqiptarë filluan të interpretoheshin jo vetëm si marrëdhënie kulturore, por edhe si kanale të mundshme të ndikimit politik të Shqipërisë mbi shqiptarët e Kosovës dhe viseve të saj nën Jugosllavi.

Për këtë arsye, akuzat kundër Shqipërisë pas demonstratave të vitit 1981 duhet të analizohen jo vetëm në aspektin e pretendimeve për ndërhyrje të jashtme, por në funksionin që ato patën në riformësimin e politikave jugosllave ndaj Kosovës. Pa dyshim që këto akuza kishin për objektiv që të gjendej preteksti i ndërprerjes së menjëhershme të marrëveshjeve të bashkëpunimit kulturor dhe arsimor në mes të shtetit shqiptar dhe gjysmës së kombit tjetër që jetonin nën sundimin e Jugosllavisë. Kjo gjë nënkuptonte dhe ndalimin e qarkullimit të literaturës shqipe dhe prishjen përfundimtare të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shqiptare në të dy anët e kufirit.

Bullgaria: pretendimet jugosllave për përfshirjen saj në demonstratat shqiptare të vitit 1981

Përveç Shqipërisë, në diskursin politik dhe të sigurisë jugosllave u shfaqën edhe interpretime që i lidhnin demonstratat shqiptare të vitit 1981 në Kosovë me ndikimin e mundshëm të shërbimeve të huaja, ndër të cilat përmendej edhe shërbimi sekret bullgar. Në kuadër të përpjekjeve për të shpjeguar shkaqet dhe faktorët e jashtëm që mund të kishin ndikuar në këto zhvillime, strukturat politike dhe të sigurisë jugosllave shqyrtuan mundësinë e përfshirjes së aktorëve të jashtëm në veprimtarinë e organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar dhe në shpërthimin e këtyre demonstratave. Megjithatë, në dokumentacionin e shqyrtuar për këtë punim nuk është identifikuar asnjë dëshmi që të vërtetojë një rol të shërbimit sekret bullgar

në organizimin e demonstratave shqiptare ose në drejtimin e veprimtarisë së organizatave të fshehta shqiptare dhe anti jugosllave

Nga pikëpamja metodologjike dhe historiografike, pretendimi për përfshirjen e një shërbimi të huaj në një proces politik kërkon prova konkrete dhe të verifikueshme. Duhet dalluar ndërmjet interesit gjeopolitik të një shteti, vlerësimit të mundësive që krijon një krizë në shtetin fqinj dhe përfshirjes operative në organizimin e një lëvizjeje. Këto kategori nuk janë të barasvlershme dhe nuk mund të përdoren si dëshmi reciproke.

Për ta kuptuar më mirë kontekstin në të cilin u shfaqën këto pretendime, është e nevojshme të shqyrtohet pozita e Bullgarisë në raport me Jugosllavinë dhe interesat e saj politike në rajon gjatë asaj periudhe. Interesi bullgar ndaj zhvillimeve në hapësirën jugosllave, ishte i pranishëm vetëm ndaj çështjes maqedonase. Dhe ky interes ishte i pranishëm që nga periudha pas Luftës së Dytë Botërore.

Marrëdhëniet jugosllavo-bullgare gjatë fundit të viteve gjashtëdhjetë dhe fillimit të viteve shtatëdhjetë ishin të karakterizuara kryesisht nga mosmarrëveshjet lidhur me çështjen maqedonase dhe interpretimin e identitetit kombëtar maqedonas. Pas kontakteve dhe bisedimeve ndërmjet udhëheqjeve politike të të dy vendeve, përfshirë takimet ndërmjet Josip Broz Titos dhe Todor Zhivkovit, udhëheqja zyrtare në Sofje vazhdoi ta kundërshtonte politikën jugosllave ndaj identitetit maqedonas[25].

Në këtë kontekst, nga provenienca e studiuesve bullgar, çështja e Kosovës nuk shfaqet si instrument i një politike kundër Jugosllavisë. Raporti për çështjen e Kosovën, gjithnjë sipas studiuesve bullgar për Kosovën, trajtohej në kuadër të analizave më të gjera të marrëdhënieve ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë[26].

I vetmi takim i konfirmuar dhe i dokumentuar ndërmjet përfaqësuesve politikë bullgar dhe udhëheqjes politike të Krahinës Autonome të Kosovës lidhet me takimet ndërmjet Mahmut Bakallit gjatë pushimeve të tij në Bullgari dhe një përfaqësuesi të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste bullgarë, Марко Марков (Marko Markov). Sipas një burimi, gazetari i asaj periudhe, Калоян Методиев (Kallojan Metodiev), kishte bërë një interviste me Марко Марков (Marko Markov), lidhur me takimin e tij me Mahmut Bakallin. Gjithnjë sipas kësaj reference, Mahmut Bakalli kishte paraqitur pikëpamjet e tij, se gjoja mbi bazën e zhvillimeve kushtetuese të pas vitit 1974, Kosova mund të avancohet më tej statusin e saj politik dhe në të ardhmen, të fitonte statusin e republikës në federatën jugosllave[27]. Mirëpo disa dekada më vonë, vet M. Bakalli e referon një të vërtet krejtësisht tjetër. Ai në një intervistë për gazetën "Zëri" në vitin 2006, deklaronte se: "... me sa di unë asnjëherë nuk është hapur në asnjë organ politik çështja e statusit të Kosovës për mundësin drejtë Republikës"[28].

Për sa i përket implikimeve të Bullgarisë lidhur me demonstratat shqiptare të vitit 1981 në Kosovë, një nga studiuesit bullgar, Йордан Величков (J. Veliçkov), këtë pikëpamje e trajton në mënyrë shumë objektive. Ai thekson se "problemi shqiptar në Kosovë përbënte një nga çështjet e rëndësishme në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Tiranës..."[29]. Sipas tij, "politika jugosllave ndaj shqiptarëve të Kosovës, e cila nga pikëpamjet politike bullgar përfshinte elemente të kontrollit politik, të integrimit institucional dhe të presioneve asimiluese, të cilat nuk kishte arritur t'i eliminonin tendencat nacionaliste dhe kërkesat për ndryshimin e pozitës

[25] Fatmir Arifi, Intervistë studimore me albanologun bullgar Anton Pançev, 17 gusht 2021.
[26] Po aty.
[27] Cituar sipas, Йордан Величков, Националните малцинства и външната политика на СФР Югославия..., f. 61.
[28] Mahmut Bakkali, intveristë, gazeta " Zëri", 29 prill 2006, f, 4.
[29] Йордан Величков, Националните малцинства и външната политика на СФР Югославия..., f. 61.

së Kosovës brenda federatës"[30]. Йордан Величков vlerësonte gjithashtu se "problemet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë përbënin ndër çështjet më të ndërlikuara në marrëdhëniet e Jugosllavisë me shtetet fqinje"[31].

Ky vlerësim është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën se si çështja e Kosovës përfshihej në analizat bullgare, në raport me politikat jugosllave dhe marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Tiranës. Megjithatë, interpretimi i interesave politike të Bullgarisë duhet dalluar nga dëshmitë për përfshirje konkrete në organizimin e demonstratave.

Në këtë kuptim, në analizën shkencore të marrëdhënieve ndërmjet Jugosllavisë dhe Bullgarisë, në kontekstin e zhvillimeve politike në Kosovë, duhet bërë dallimi ndërmjet interesit gjeopolitik bullgar për dobësimin e mundshëm të pozitës së Jugosllavisë dhe ekzistencës së një politike konkrete për të ndikuar në demonstratat shqiptare të vitit 1981.

Në bazë të dokumenteve dhe vlerësimeve të trajtuara në këtë punim, konstatohet se faktori bullgar nuk pati asnjë rol, qoftë mbështetës apo organizativ në demonstratat shqiptare të vitit 1981. Deri në identifikimin e provave të drejtpërdrejta, çdo pretendim për përfshirje operative duhet të paraqitet si hipotezë e pakonfirmuar dhe jo si përfundim historik.

Përfshirja e Bashkimit Sovjetik në diskursin jugosllav, lidhur me demonstratat shqiptare të vitit 1981

Një aspekt tjetër i diskursit politik jugosllav pas demonstratave shqiptare të vitit 1981 lidhej me pretendimet për përfshirjen e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) në zhvillimet në Kosovë. Dhe këto pretendime duhet të shqyrtohen në kontekstin e marrëdhënieve sovjeto-jugosllave, veçanërisht, pas vdekjes së diktatorit Tito dhe të dyshimeve që vazhdonin të karakterizonin raportet ndërmjet dy vendeve.

Sipas një raporti të Byrosë së Inteligjencës dhe Kërkimeve të Departamentit të Shtetit të SHBA-së, të datës 16 qershor 1981, trajtohej se "trazirat e marsit dhe prillit në Kosovë kishin ringjallur dyshimet e Beogradit se Moska mund të përpiqej t'i shfrytëzonte tensionet e brendshme për të krijuar një pretekst për ndërhyrje në Jugosllavi"[32]. Ndërsa një raport tjetër i Departamentit të shtetit të SHBA-së theksonte se, menjëherë pas shtypjes së demonstratave, në shtypin jugosllav dhe në deklaratat e përfaqësuesve të udhëheqjes politike jugosllave u shfaqën akuza të tërthorta për të ashtuquajtur "bashkëfajësi shqiptaro-sovjetike"[33]. Këto raporte, ishin hartuar mbi bazën e diskursit politik të vet drejtuesve federativ jugosllav. Njëri nga këta ishte, Stane Dolanc, anëtari i presidencës së Jugosllavisë, i cili deklaronte se demonstratat ishin organizuar nga emigrantë që kishin lidhje me "Kominformin"[34]. Ndërsa në Beograd qarkullonin pretendime se Moska i kishte furnizuar me armë kundërshtarët e regjimit në Kosovë dhe se trazirat ishin rezultat i një komploti sovjeto-shqiptar. Megjithatë, analiza e sigurisë së institucioneve

[30] Po aty
[31] po aty
[32] Report Prepared in the Bureau of Intelligence and Research, "Soviet-Yugoslav Relations Since Tito," Ëashington, 16 June 1981, *Foreign Relations of the United States, 1981–1988, Volume X: Eastern Europe*, doc. 193, f. 537, https://history.state.gov/historicaldocuments/frus1981-88v10/d193.
[33] U.S. Department of State, Bureau of Intelligence and Research, "Soviet-Yugoslav Relations Since Tito," Foreign Relations of the United States, 1981-1988, Volume X: Eastern Europe, Document 193, Ëashington, 16 June 1981, veçanërisht seksioni "Repressed Soviet-Yugoslav Tensions Reemerge Over Kosovo". Dokumenti i plotë në arkivin zyrtar të Departamentit të Shtetit të SHBA-së.
[34] Po aty

amerikane, ishte e qartë. Aty referohej se "autoritetet jugosllave, me sa dukej, nuk disponojnë prova për përfshirjen sovjetike në këto ngjarje"[35].
Ky konstatim është veçanërisht domethënës për vlerësimin kritik të mënyrës se si organet jugosllave i paraqisnin demonstratat shqiptare të vitit 1981, gjoja si komplote të shqiptarëve kundër tyre. Raporti i organeve të sigurisë amerikane dëshmon se dyshimet raportin e forcave gjeopolitike, Beogradit synonte ta shndërronte në pretendime publike për gjoja ndërhyrje të jashtme. Ndërkohë që vlerësimi i strukturave të specializuara të SHAB-së, nuk identifikonin prova për përfshirjen sovjetike. Në këtë mënyrë, kriza politike dhe kombëtare në Kosovë u vendos edhe brenda kornizës së rivalitetit sovjeto-jugosllav, ndërsa kërkesat politike të shqiptarëve interpretoheshin si pjesë e një skenari të supozuar për de stabilizimin e Jugosllavisë nga jashtë.
Në kuadër të këtyre pretendimeve jugosllave, Mehmet Hajrizi, shkruan: "Kur i mbledh bashkë të gjitha trillimet për infiltrimet e jashtme në Kryengritjen popullore të vitit 1981, del një lëmsh i pa fill dhe paradoksal i 'kolaborimit' të Tiranës dhe Moskës zyrtare, i marksistëve dhe reaksionarëve, i rinisë 'së indoktrinuar nga Shqipëria e Enver Hoxhës' dhe Beogradit, i Bullgarisë socialiste e Perëndimit kapitalist etj.! Gjithë të armiqësuarit e botës u pajtuan dhe u bënë bashkë për të organizuar demonstrata në Kosovë dhe për ta dëmtuar Jugosllavinë socialiste dhe vetëqeverisëse"[36].
Kështu, pretendimet për përfshirjen e shërbimeve të huaja nuk mbështeten në prova konkrete të identifikuara në burimet e shqyrtuara, ndërsa dosjet hetimore dëshmojnë rëndësinë që autoritetet jugosllave i kushtuan veprimtarisë paraprake të organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar. Veprimtarët e këtyre organizatave u ndoqën penalisht dhe u burgosën pas demonstratave. Kjo e përforcon nevojën që demonstratat e vitit 1981 të analizohen edhe në raport me organizimin politik dhe veprimtarinë e brendshme shqiptare, pa u kufizuar në narrativat jugosllave për ndërhyrje të jashtme.

Nga "armiku i jashtëm" te identifikimi i "armikut të brendshëm"

Irredentizmi, separatizmi dhe kundërrevolucioni në diskursin politik e juridik të Jugosllavisë socialiste

Pas demonstratave shqiptare të vitit 1981, autoritetet jugosllave u përpoqën t'i shpjegonin ngjarjet e Kosovës përmes pretendimeve për ndikime dhe ndërhyrje të jashtme. Megjithatë, kur këto pretendime nuk u shoqëruan me prova bindëse për organizimin e demonstratave nga forca të huaja, vëmendja e diskursit politik zyrtar jugosllav u përqendrua gjithnjë e më shumë te identifikimi dhe trajtimi i të ashtuquajturit **"armik i brendshëm".**
Ky diskurs nuk nënkuptonte braktisjen e narrativës për ndërhyrjen e jashtme, por synonte ndërthurjen e saj me një interpretim politik dhe juridik, sipas të cilit veprimtaria atdhetare shqiptare përbënte kërcënim ndaj rendit socialist, integritetit territorial dhe organizimit kushtetues të Jugosllavisë.

[35] Po aty.
[36] Mehmet Hajrizi, "*Dhjetë qëndrime të gabuara ndaj kryengritjes së vitit 1981...*", f, 25-25.

Në këtë mënyrë, kërkesat për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën Jugosllavi, të artikuluar nga organizatat e fshehta shqiptare me orientim çlirimtar, u paraqitën në diskursin zyrtar si veprimtari që cenonin rendin politik dhe kushtetues të federatës. Ky interpretim duhet analizuar si pjesë e gjuhës politike të autoriteteve dhe jo të merret si përshkrim neutral i qëllimeve ose i veprimtarisë së këtyre organizatave.

Në sistemin politik të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), ruajtja e rendit socialist, e organizimit federal dhe e marrëdhënieve të përcaktuara ndërmjet kombeve dhe kombësive konsiderohej pjesë themelore e rendit kushtetues. Megjithatë, federata përfshinte popuj me histori, tradita, kultura, përvoja shtet formuese dhe identitete kombëtare të ndryshme, të cilat nuk mund të reduktoheshin në një trashëgimi të vetme të përbashkët. Përmes kuadrit të përbashkët institucional dhe ideologjik socialist, sistemi jugosllav synonte të harmonizonte këto dallime, por nuk arriti t'i eliminonte kundërthëniet politike dhe kombëtare që buronin prej tyre.

Në këtë kontekst, çështja shqiptare në Kosovë përbënte një nga sfidat më të ndërlikuara të federatës. Shqiptarët përbënin një popullsi me identitet të konsoliduar historik, gjuhësor e kulturor. Kushtetuta e vitit 1974 i zgjeroi pjesërisht kompetencat e Krahinës Autonome të Kosovës brenda federatës, por nuk e shndërroi atë në republikë dhe nuk e eliminoi varësinë e saj kushtetuese nga Republika Socialiste e Serbisë[37].

Përballë kërkesave politike dhe kombëtare të shqiptarëve, autoritetet jugosllave përdorën një terminologji politike dhe juridike përmes së cilës veprimtaritë e konsideruara kërcënuese për rendin shtetëror klasifikoheshin si nacionaliste, irredentiste, separatiste ose kundërrevolucionare. Këto kategori nuk kishin të njëjtën përmbajtje, por në diskursin zyrtar shpesh përdoreshin në mënyrë të ndërthurur[38]. Ky interpretim duhet dalluar nga analiza e përmbajtjes konkrete të kërkesave dhe e rrethanave që i kishin nxitur ato.

Në këto rrethana u formulua një diskurs politik zyrtar përmes të cilit kërkesat e shqiptarëve dhe veprimtaria e organizatave të fshehta shqiptare u lidhën me figurën e "armikut të brendshëm". Përmes kësaj kategorie, kundërshtimi politik dhe mobilizimi kombëtar shqiptar u interpretuan si kërcënim ndaj rendit ekzistues, duke e zhvendosur debatin nga përmbajtja e kërkesave drejt çështjes së besnikërisë ndaj shtetit dhe sistemit socialist[39].

Në këtë mënyrë, dallimi ndërmjet kërkesave politike, veprimtarisë së organizuar kombëtare dhe veprave konkrete penale ishin në kontradiktë. Etiketimet ideologjike ndikonin në mënyrën se si institucionet e sigurisë dhe organet gjyqësore i klasifikonin individët, organizatat dhe veprimtaritë e tyre. Për këtë arsye, dokumentet e sigurisë duhet të shqyrtohen në raport me aktet konkrete dhe me dispozitat ligjore të zbatueshme.

Nga pikëpamja juridike, nocioni "kundërrevolucion" kishte përmbajtje të përcaktuar në Kodin Penal të RSFJ-së. Neni 114, me titull "Rrezikimi kundërrevolucionar i rendit shoqëror", parashikonte përgjegjësi penale për veprime që synonin, ndër të tjera, cenimin e sistemit kushtetues socio-ekonomik e socio-politik, përmbysjen antikushtetuese të organeve të pushtetit, shkatërrimin e "vëllazërim-bashkimit" ose ndryshimin antikushtetues të organizimit

[37]Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmbledhje e dispozitave federative, Gazeta Zyrtare, Beograd, 1974, Neni 1 dhe 2, f. 27

[38] Diskutim nga Sinan Hasani në kuadër të Mbledhja e shtatëmbëdhjetë e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës..., f, 102.

[39] Socialist Federal Republic of Yugoslavia, "Criminal Code of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", (1977), art. 114, "Counter-revolutionary endangering of the social system", Official Gazette of the SFRY, no. 44/76. https://www.refëorld.org/legal/legislation/natlegbod/1977/13685

federal. Kjo dispozitë përbënte një bazë të rëndësishme juridike për ndjekjen e veprimtarive që autoritetet i cilësonin si kundërrevolucionare[40].

Një kategori tjetër e rëndësishme lidhej me integritetin territorial të federatës. Neni 116 i Kodit Penal të RSFJ-së, me titull "Rrezikimi i tërësisë territoriale", parashikonte përgjegjësi për veprimet që synonin shkëputjen e një pjese të territorit të RSFJ-së me forcë ose në mënyrë tjetër antikushtetuese, si dhe bashkimin e saj me një shtet tjetër. Paragrafi i dytë i këtij neni trajtonte ndryshimin antikushtetues të kufijve ndërmjet republikave dhe krahinave autonome[41]. Kjo dispozitë është e rëndësishme për të kuptuar bazën juridike mbi të cilën autoritetet formulonin akuza për veprimtari separatiste. Megjithatë, ekzistenca e kësaj norme nuk nënkupton se çdo kërkesë për ndryshimin e statusit kushtetues të Kosovës përbënte automatikisht vepër penale. Për një vlerësim të tillë nevojitet shqyrtimi i veprimeve konkrete, i qëllimeve të provuara dhe i mënyrës se si dispozita zbatohej në praktikën gjyqësore.

Në këtë kuadër duhet vendosur edhe nocioni i "irredentizmit", i cili në diskursin politik jugosllav përdorej veçanërisht për të karakterizuar veprimtari që autoritetet zyrtare i interpretonin si përpjekje për bashkimin e shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë[42].

Nga pikëpamja juridike, është e rëndësishme të theksohet se nocioni "irredentizëm" nuk parashikohej si emërtim i veçantë i një vepre penale në Kodin Penal federal të RSFJ-së të vitit 1977. Veprimtaritë që autoritetet i cilësonin si irredentiste mund të lidheshin me dispozita të ndryshme penale, në varësi të veprimeve konkrete dhe të interpretimit të organeve të ndjekjes. Për këtë arsye, kualifikimi politik dhe kualifikimi juridik duhen trajtuar si dy nivele të dallueshme analize.[43]

Nga pikëpamja konceptuale, "kundërrevolucioni" e vendoste veprimtarinë në kuadrin e një kërcënimi ndaj rendit socialist dhe organizimit kushtetues të RSFJ-së; "separatizmi" lidhej me synimin për shkëputje territoriale ose ndryshim antikushtetues të organizimit shtetëror; ndërsa "irredentizmi" nënkuptonte, në diskursin jugosllav, orientimin drejt bashkimit me një shtet tjetër mbi bazë kombëtare. "Nacionalizmi" ishte kategori më e gjerë politike dhe ideologjike. Megjithëse këto nocione kishin përmbajtje të ndryshme, në diskursin zyrtar jugosllav ato ndërthureshin dhe përdoreshin për de legjitimimin e kërkesave politike e kombëtare të shqiptarëve në Kosovë.

Për rrjedhojë, në varësi të interpretimit politik dhe juridik të autoriteteve jugosllave, e njëjta veprimtari mund të cilësohej si nacionaliste, separatiste, irredentiste ose kundërrevolucionare. Ky përdorim i ndërthurur i kategorive tregon se etiketimi politik nuk përputhej me një kualifikim të vetëm juridik.

Pikërisht kjo ndërthurje përbën një nga aspektet kryesore të ndërtimit të figurës së "armikut të brendshëm" pas demonstratave shqiptare të vitit 1981. Kategoritë politike dhe juridike nuk shërbenin vetëm për të përshkruar veprimtari të caktuara, por edhe për të përcaktuar kuptimin politik që u jepej atyre dhe për të legjitimuar reagimin institucional ndaj tyre. Në këtë mënyrë, kërkesat për të drejtat kombëtare shqiptare dhe për ndryshimin e statusit politik të Kosovës vendoseshin brenda një kornize që theksonte rrezikun ndaj shtetit, duke kufizuar hapësirën për trajtimin e tyre si çështje politike dhe kushtetuese.

[40] Po aty
[41] Po aty, art. 116.
[42] Po aty, art 136
[43] Gazeta *Rilindja*, "Organizatorët e trazirave elementë irredentistë", 4 prill 1981, f. 1, 4.

Për këtë arsye, analiza e dokumenteve arkivore duhet të shqyrtojë jo vetëm mënyrën se si formuloheshin akuzat përmes termave "separatizëm", "irredentizëm" dhe "kundërrevolucion", por edhe se kush i artikulonte, në çfarë rrethanash, kundër cilëve individë ose organizata dhe me çfarë pasojash politike e juridike. Vetëm përmes dallimit ndërmjet përmbajtjes së dokumentuar të veprimtarive të organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar dhe gjuhës ideologjike të autoriteteve zyrtare mund të kuptohet se si diskursi jugosllav e ndërtoi figurën e "armikut të brendshëm" dhe si ndikoi kjo kategori në trajtimin politik e juridik të çështjes shqiptare në Kosovë pas vitit 1981.

Përfundime

Analiza e diskursit politik dhe të sigurisë jugosllave mbi demonstratat shqiptare të vitit 1981 tregon se interpretimi i këtyre ngjarjeve u zhvillua në një kontekst të ndërlikuar, ku ndërthureshin shqetësimet për stabilitetin e federatës, kundërthëniet e brendshme politike dhe kombëtare, si dhe interesat gjeopolitike të shteteve të tjera. Në këtë proces, narrativa e "armikut të jashtëm" u bë një nga mënyrat kryesore përmes së cilave autoritetet jugosllave u përpoqën ta shpjegonin krizën e Kosovës. Megjithatë, shqyrtimi i qëndrimeve të ndryshme politike dhe i burimeve të paraqitura në këtë punim tregon se ky interpretim nuk ishte plotësisht i njëtrajtshëm dhe se pretendimet për ndërhyrje të huaj nuk mund të trajtohen automatikisht si fakte të vërtetuara.

Në rrafshin e parë të analizës, shqyrtimi i qëndrimeve të përfaqësuesve të udhëheqjes jugosllave dëshmon se, menjëherë pas shpërthimit të demonstratave, ekzistonin dallime në mënyrën se si interpretoheshin shkaqet dhe përmasat e krizës. Disa përfaqësues, si Stane Dolanc, e paraqitën mobilizimin shqiptar si rezultat të veprimtarisë së forcave të jashtme armiqësore, ndërsa qëndrimi më i rezervuar i Jože Smoles dëshmon se brenda udhëheqjes jugosllave kishte edhe zëra që paralajmëronin kundër ekzagjerimit të rolit të faktorëve ndërkombëtarë. Edhe qëndrimi i Dobrica Ćosiqit, ndonëse i formësuar nga perspektiva e tij nacionaliste serbe dhe jo nga një mbështetje për të drejtat kombëtare të shqiptarëve, tregon se shpjegimi i çështjes shqiptare vetëm përmes ndikimit të jashtëm ishte i pamjaftueshëm për të kuptuar dimensionin e saj historik e politik. Këto dallime e mbështesin përfundimin se narrativa e "armikut të jashtëm" u konsolidua brenda një debati politik dhe nuk përbënte që në fillim një interpretim të vetëm, të pranuar pa rezerva nga të gjithë përfaqësuesit e elitës jugosllave.

Shqyrtimi i akuzave për përfshirjen e Shqipërisë, Bullgarisë dhe Bashkimit Sovjetik nxjerr në pah nevojën për të dalluar interesin politik dhe gjeopolitik nga ndërhyrja konkrete në organizimin e demonstratave. Në rastin e Shqipërisë, burimet e shqyrtuara dëshmojnë se autoritetet jugosllave e paraqitën Tiranën zyrtare si një faktor të rëndësishëm të ndikimit ideologjik dhe politik mbi shqiptarët në Kosovë. Megjithatë, në materialin e analizuar nuk është identifikuar një dokument i drejtpërdrejtë që të vërtetojë se institucionet shtetërore shqiptare i organizuan demonstratat e vitit 1981. Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet arsimore, kulturore dhe shkencore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë gjatë viteve shtatëdhjetë dëshmojnë ekzistencën e kanaleve institucionale të bashkëpunimit, të cilat kishin rëndësi për zhvillimin e arsimit dhe të jetës intelektuale shqiptare. Këto marrëdhënie duhet të analizohen në kontekstin e tyre historik, pa u barazuar automatikisht me veprimtari të fshehta ose me organizimin e demonstratave.

Sa i përket Bullgarisë, burimet dhe vlerësimet e trajtuara në punim nuk ofrojnë prova për të konfirmuar një rol të shtetit ose të shërbimeve të tij në organizimin e demonstratave. Rivaliteti politik dhe ideologjik ndërmjet Sofjes dhe Beogradit, si dhe interesimi bullgar për zhvillimet në Jugosllavi, përbëjnë pjesë të kontekstit ndërkombëtar të kohës, por nuk dëshmojnë vetvetiu ekzistencën e një politike operative për mbështetjen ose drejtimin e demonstratave shqiptare. Në mënyrë të ngjashme, raporti amerikan i 16 qershorit 1981, i shqyrtuar në këtë punim, tregon se dyshimet për përfshirjen sovjetike u rishfaqën në kontekstin e shqetësimeve të Beogradit për sigurinë e Jugosllavisë, por se, sipas vlerësimit amerikan, autoritetet jugosllave me sa dukej nuk dispononin prova për përfshirjen e Bashkimit Sovjetik.

Për rrjedhojë, hipoteza se akuzat për ndërhyrje të jashtme u përdorën si një kornizë politike për interpretimin e krizës së Kosovës nuk gjen mbështetje në burimet e shqyrtuara. Dokumentacioni i analizuar provon se çdo pretendim për ndikim të jashtëm ishte i fabrikuar.

Një përfundim tjetër i rëndësishëm lidhet me mënyrën se si narrativa e "armikut të jashtëm" u ndërthur me ndërtimin e figurës së "armikut të brendshëm". Kur zhvillimet në Kosovë u interpretuan përmes kategorive të "irredentizmit", "separatizmit" dhe "kundërrevolucionit", veprimtaria politike dhe kombëtare shqiptare u vendos gjithnjë e më shumë brenda kornizës së sigurisë shtetërore dhe të mbrojtjes së rendit kushtetues jugosllav. Këto kategori nuk ishin sinonime të plota, por në diskursin zyrtar shpesh ndërthureshin, duke mundësuar që kërkesat për ndryshimin e statusit të Kosovës dhe veprimtaritë e organizatave të fshehta shqiptare të paraqiteshin si pjesë të një kërcënimi të gjerë ndaj shtetit.

Shqyrtimi i Kodit Penal federal të vitit 1977 e qartëson dallimin ndërmjet kategorive politike dhe dispozitave konkrete juridike. Nocioni "irredentizëm" nuk paraqitej si emërtim i veçantë i një vepre penale në këtë kod, ndërsa veprimtaritë e cilësuara si irredentiste mund të ndiqeshin në bazë të dispozitave të tjera, veçanërisht atyre që lidheshin me rrezikimin kundërrevolucionar të rendit shoqëror dhe me cenimin e integritetit territorial të federatës. Ky dallim është thelbësor, sepse tregon se përdorimi i një etikete politike nuk mjafton për të përcaktuar nëse një veprim konkret përmbushte kushtet e një vepre penale. Një vlerësim i tillë kërkon shqyrtimin e akteve konkrete, të provave, të dispozitave të zbatueshme dhe të praktikës gjyqësore.

Në këtë kuptim, hipoteza e dytë e punimit, sipas së cilës kategoritë politike dhe juridike kontribuuan në paraqitjen e kërkesave shqiptare si problem i sigurisë shtetërore, mbështetet nga mënyra se si këto nocione shfaqeshin në diskursin zyrtar dhe nga funksioni që ato morën në interpretimin e krizës. Megjithatë, për të përcaktuar plotësisht pasojat juridike të këtij diskursi, është e nevojshme që analiza e përgjithshme të plotësohet, aty ku është e mundur, me shqyrtimin e aktakuzave, vendimeve gjyqësore dhe dokumenteve konkrete të ndjekjes penale. Vetëm kështu mund të përcaktohet më saktë raporti ndërmjet gjuhës politike, dispozitave ligjore dhe zbatimit të tyre ndaj individëve e organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar.

Në anën tjetër, dokumentacioni i trajtuar e bën të domosdoshme që demonstratat e vitit 1981 të analizohen edhe në raport me faktorët e brendshëm politikë, shoqërorë dhe kombëtarë. Statusi kushtetues i Kosovës pas vitit 1974, kërkesat për avancimin e pozitës së saj politike dhe veprimtaria paraprake e organizatave të fshehta shqiptare me orientim çlirimtar përbëjnë elemente të rëndësishme për të kuptuar kontekstin e mobilizimit. Këta faktorë nuk e përjashtojnë nevojën për të shqyrtuar ndikimet e mundshme të jashtme, por tregojnë se një

shpjegim që mbështetet vetëm në akuzat për ndërhyrje të huaj mbetet i pamjaftueshëm për të kuptuar kompleksitetin e zhvillimeve në Kosovë.

Në përfundim, analiza mbështet interpretimin se narrativa e "armikut të jashtëm" dhe konstruksioni politik e juridik i "armikut të brendshëm" përbënin dy dimensione të ndërlidhura të mënyrës se si autoritetet jugosllave e trajtuan krizën e Kosovës pas demonstratave të vitit 1981. E para e lidhte krizën me pretendime për ndikim ose ndërhyrje nga jashtë, ndërsa e dyta e vendoste veprimtarinë politike dhe kombëtare shqiptare brenda kategorive të rrezikimit të rendit socialist dhe integritetit territorial. Kjo ndërthurje e zhvendoste qendrën e interpretimit nga shqyrtimi i shkaqeve të brendshme të pakënaqësisë drejt çështjes së sigurisë shtetërore dhe të legjitimitetit të rendit ekzistues.

Rëndësia historiografike e këtij studimi qëndron në dallimin ndërmjet asaj që institucionet jugosllave pretendonin dhe asaj që dokumentacioni mund të dëshmojë. Një qasje e tillë nuk përjashton apriori çdo ndikim të jashtëm, por kërkon që secili pretendim të vlerësohet në bazë të provave dhe të kontekstit historik. Vetëm përmes këtij dallimi mund të kuptohet më mirë se si u ndërtua narrativa zyrtare mbi demonstratat shqiptare të vitit 1981, si u përdorën kategoritë politike dhe juridike për të interpretuar veprimtarinë shqiptare dhe si ndikoi kjo mënyrë interpretimi në trajtimin e çështjes së Kosovës në vitet pasuese.

Refrences

[1] Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK), Fondi: Gjykata e Qarkut – Prishtinë, Njësia Organike Penale.

[2] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ).

[3] Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), Fondi 14/APSTR, viti 1979, dosja 64,

[4] Hrvatski Državni Arhiv (HDA), fondi: Savezni sekretarijat za unutrašnje poslove, "Analitički osvrt: Saradnja albanske neprijateljske emigracije sa albanskom obaveštajnom službom i podrška MSR Albanije pokretu za Albansku Socijalističku Republiku u Jugoslaviji"

[5] Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, "Platforma politike për aksionin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, të vëllazërim-bashkimit dhe të bashkëjetesës në Kosovë", Beograd, 17 nëntor 1981.

[6] Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmbledhje e dispozitave federative, Gazeta Zyrtare, Beograd, 1974.

[7] Mbledhja e shtatëmbëdhjetë e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, "Vlerësimi i shkaqeve, i rrethanave dhe i pasojave të demonstratave armiqësore dhe organizimi e veprimi i LK dhe i fuqive të tjera të organizuara socialiste në Kosovë", Komunisti, Prishtinë, 1981.

[8] Socialist Federal Republic of Yugoslavia, "Criminal Code of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", Official Gazette of the SFRY, no. 44/76, 1977.

[9] Hajrizi, Mehmet & Sylaj, Gani, Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës (Dokumente dhe materiale), Instituti i Historisë "Ali Hadri" dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Prishtinë, 2014.

[10] Hajrizi, Mehmet, "Dhjetë qëndrime të gabuara ndaj kryengritjes së vitit 1981", në: Demonstratat e vitit 1981 dhe politika shqiptare, përmbledhje aktesh nga konferenca shkencore, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2014.

[11] Qosiq, Dobrica, Kosovo, Novosti, Beograd, 2004.

[12] Йордан Величков. Националните малцинства и външната политика на СФР Югославия. София, 1979

[13] Gazeta Rilindja, "Kundër veprimtarisë armiqësore do të ndërmarrim të gjitha masat përkatëse", 3 prill 1981.

[14] Gazeta Rilindja, “Organizatorët e trazirave elementë irredentistë”, 4 prill 1981.
[15] Përmbledhja e materialeve të Mbledhjes së shtatëmbëdhjetë të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës.
[16] Politika, “Шта се догађало на Косову”, Beograd, maj 1981.
[17] Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981.
[18] Zëri ditor
[19] Arifi, Fatmir, intervistë studimore me albanologun bullgar Anton Pançev, 17 gusht 2021.
[20] U.S. Department of State, Bureau of Intelligence and Research, “Soviet-Yugoslav Relations Since Tito”, Foreign Relations of the United States, 1981–1988, Volume X: Eastern Europe, Document 193, Ëashington, 16 June 1981. https://history.state.gov/historicaldocuments/frus1981-88v10/d193
[21] Socialist Federal Republic of Yugoslavia, Criminal Code of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia, 1977, https://www.refëorld.org/legal/legislation/natlegbod/1977/13685